



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 5860 prot.

Ballsh më, 02 . 12 . 2024

VENDIM

Nr. 59 Datë 26 / 11 / 2024

PËR

MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË INVENSTIMIT NDËRMJET FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE BASHKISË MALLAKASTËR ME OBJEKT “NDËRHYRJE PËR PËRMIRËSIMIN E SHTRESAVE ASFALTIKE NË SEGMENTIN RRUGOR HEKAL – KLOS, BASHKIA MALLAKASTËR” DHE MIRATIMIN NË PARIM PËR SHPRONËSIMIN / ZHDËMTIMIN E PRONAVE QË MUND TË PREKEN NGA ZBATIMI I KËTIJ PROJEKTI

Mbështetur në nenin 9, pika 1 2, shkronja “b”, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër për objektin “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike në segmentin rrugor Hekal - Klos, Bashkia Mallakastër”, në Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar,

VENDOSI

- I. Miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër për objektin “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike në segmentin rrugor Hekal – Klos, Bashkia Mallakastër”.

- II. Miratimin në parim për shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i projektit me objekt “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike në segmentin rrugor Hekal – Klos, Bashkia Mallakastër”.
- III. Kompensimi financiar dhe procedurat lidhur me shpronësimin / zhdëmtimin e pronave që mund të preken nga zbatimi i këtij projekti do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

